



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 739/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “Shendelli” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-34675-08-31-2019, me objekt: “Rehabilitim/perforcim të banesave ekzistuese në fshatin Piskove dhe Pacomit”, me fond limit 9.905.233 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.

**Ankimues:** “Shendelli” sh.p.k  
L. “Kastriot”, Rr. “A.Profka”, “2 Kullat”, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Përmet.  
Sheshi “Abdyl Frashëri”, Përmet

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.09.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-34675-08-31-2019, me objekt: “*Rehabilitim/perforcim të banesave ekzistuese në fshatin Piskove dhe Pacomit*”, me fond limit 9.905.233 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.

II.2. Në datën 30.09.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1.	“Kevin Konstruksion” sh.p.k	8.094.988 lekë, skualifikuar
2.	“Fled” sh.p.k	8.328.944 lekë, skualifikuar
3.	“Shendelli” sh.p.k	8.885.527 lekë, skualifikuar
4.	“Ndregjoni” sh.p.k	9.111.457 lekë, kualifikuar
5.	“Senka” sh.p.k	9.195.835 lekë, skualifikuar
6.	“Meni” sh.p.k	9.635.811 lekë, skualifikuar
7.	“Eurostil” sh.p.k	9.656.790 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO me argumentat si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik “Shendelli” shpk ka dorezuar (shtojcen 9) ku ka deklaruar makinerite ne pronesi dhe me qera.*

*Nga verifikimi i shtojces 9 dhe nga dokumentacioni qe ka paraqitur ne sistemin elektronik KVO konstatoi se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin per mjetet si me poshte:*

*1- Mjetin me targa GJ1127B ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar autovinc ku ka paraqitur kontraten e qerases me subjektin Aliko Ndertim ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto por i mungon certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet nuk eshte i plote per rrjedhoje i pasakte.*

*2- Mjetin me targa AA043XL ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten pronesie, foto por certifikata e kontrollit teknik eshte per mjetin me targa SK125GA. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet nuk eshte i plot per rrjedhoje i pasakte.*

*3- Mjetin me targa AA409DR ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamion me vinc ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte.*

*4- Mjetin me targa AA886SG ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar vinc me kosh ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte.*

*5- Mjetin me targa AA074PU, ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte.*

*6- Mjetin me targa AA959GS ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte.*

*7- Mjetin me targa AA693OY ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte.*

*8- Mjetin me targa SR4937B ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamion ku ka paraqitur kontraten e qerases me subjektin “JODY” ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash, foto dhe certifikata e pronesise. Per rrjedhoje dokumentacioni per kete mjet eshte i plote dhe i sakte.*

*9- Mjetin me targa AA545JN ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar AUTOVINC ku ka paraqitur kontraten e qerases, ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit nuk ka kerkuar autovinc por vinc me kosh.*

*10- Mjetin me targa AA969TY ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar AUTOVINC ku ka paraqitur kontraten e qerases, ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit*

teknik, foto dhe certifikata e pronesisë. Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk ka kërkuar autovinc por vinc me kosh.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentave për operatorin ekonomik "Shendelli" shpk konstatohet se dokumentacioni i makinerive nuk është i plotë dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga AK Bashkia Permet.

Nga mjetet e deklaruara në shtojcën 9 dhe dokumentacioni përkatës në sistemin elektronik operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të saktë vetëm për një kamion dhe konkretisht për mjetin me targa SR4937B. Autoriteti kontraktor Bashkia Permet në dokumentat e tenderit ka kërkuar dy kamione me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 5 ton, ku operatori ekonomik përmbush kushtin vetëm për një kamion.

Në nenin 46, pikë 1 gërma "c" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se " [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese:

Neni 53 pikë 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. "

II.3. Në datën 03.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

"Operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k nuk është dakort me skualifikimin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe po argumentojmë arsyet e poshtëshënuara:

Duke iu referuar DST ju kerkoni:

Kamioncina (kapaciteti mbajtës deri minimumi 1 ton maksimumi 2 ton) 2 cope, në pronësi ose me qera.

Në ju kemi paraqitur keto:

1- Mjetin me targa AA074PU, ku në shtojcën 9 e ka deklaruar kamioncinë ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, foto dhe certifikatën e pronesisë. Për rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet është i saktë. ton 1.3

2- Mjetin me targa AA6930Y ku në shtojcën 9 e ka deklaruar kamioncinë ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, foto dhe certifikatën e pronesisë. Për rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet është i saktë. ton 1.09

3- Mjetin me targa AA959GS ku në shtojcën 9 e ka deklaruar kamioncinë ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, foto dhe certifikatën e pronesisë. Për rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet është i saktë. ton 1.227

4-Mjeti me targa AA347KE është me dokumentacion të plotë kamioncinë ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, foto dhe certifikatën e pronesisë. Për rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet është i saktë. ton 1.945

*Per mjetet e permendura me sipër ju deklaroni se janë të sakta pra është plotësuar nga ana jone kërkesa e dhënë në dsh.*

*Ju kerkoni*

*Kamiona vetëshkarkuese (kapaciteti mbajtes nga 3.5 ton deri në 5 ton ), 2 cope, pronesi ose me qera.*

*Ne ju kemi paraqitur: Mjetin me targa AA043XL. Ju për këto mjet deklaroni:*

*Mjetin me targa AA043XL ku në shtojcën 9 e ka deklaruar kamioncinë ka paraqitur lejen e qarkullimit, policën e sigurimit, certifikatën pronësie, foto për certifikatën e kontrollit teknik është për mjetin me targa SK125GA. Për rrjedhojë dokumentacioni për këto mjet nuk është i plotë për rrjedhojë të pasakte.*

*Kundershtim pika:*

*Për mjetin me targa AA043XL ne ju kemi paraqitur: Certifikatën transport në emer të Shendelli sh.p.k date 28/02/2019 me numer shasie ËDB6690421P123340, Leja e qarkullimit me Nr shasie: ËDB6690421P123340 në emer të Shendelli sh.p.k, date 13/05/2019, taksat vjetore në emer të Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 me numer shasie ËDB6690421P123340, sigurimi teknik në emer të Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 Me nr shasie ËDB6690421P123340, Tahografi në emer të Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 me nr shasie ËDB6690421P123340, Certifikatën e kontrollit teknik me targa SK125GA me numer shasie ËDB6690421P123340, Pronësia në emer të Shendelli sh.p.k me nr shasie ËDB6690421P123340 date 19.02.2019.*

*Pra sa me sipër dokumentacioni i paraqitur nga ana jone tregon që është e njëjta makinë dhe kjo faktohet me nr e shasise të cilin është e njëjta të të gjitha dokumentat. Pra dokumentat e paraqitura të folderit "Shendelli" Kamion AA043XL 3.66 TON 30.10.2019" i perkasin të njëjtit mjet dhe jo dy mjete të ndryshme sic pretendon AK. Kjo makinë është blerë nga shoqëria jone nga Arta Flamur Omeri, e cila figuron si emer në disa dokumentat, por ky automjet tashmë është i shoqërisë sonë dhe faktohet nga akti i pronësisë dhe dokumentacioni i paraqitur është i rregullt deri me datën 31/10/2019.*

*Pra dokumentacioni është i rregullt dhe Ak mund të verifikojë duke iu referuar nr të shasise, element të cilin nuk ndryshon asnjëherë të një automjet. Mjeti ka tonazhin 3.66 ton dhe është i rregullt.*

*Pretendimi juaj që mjeti me targa AA043XL nuk ka dokumentacionin e sakte nuk qëndron.*

*Ne ju kemi paraqitur: Mjetin me targa GJ1127B*

*Mjetin me targa GJ1127B ku në shtojcën 9 e ka deklaruar autovincin ku ka paraqitur kontratën e qerës me subjektin Alike Ndertim ka paraqitur lejen e qarkullimit, policën e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, certifikatën për transport mallrash nga bashkia, foto për i mungon certifikatën e pronësisë.*

*Mjetin me targa GJ11276 ka tonazh 4.940.*

*Ky mjet nuk ka certifikatën e pronësisë, por kjo nuk do të thotë që dokumentacioni është i pasakte dhe se pronësia e mjetit nuk verifikohet, pasi pronësinë e mjetit e tregon dhe leja e qarkullimit dhe dokumentacioni tjetër bashkangjitur. Pronësia është një element e cila faktohet dhe me dokumenta të tjera përveç certifikatës së pronësisë, dhe mungesa e saj nuk do të thotë që të gjithë dokumentacioni është i parregullt dhe nuk mund të merret parasysh nga Ak.*

Ne kete rast po ti referohemi ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, ndryshuar me ligjin Nr.9800 date 10.09.2007, ligjin Nr. 9855 date 26.12.2007, ligjin nr. 10170, date 22.10.2009, dhe ligjin nr.10309, date 22.07.2010, i cili eshte rregullatori kryesor per procedurat e prokurimit publike, ne nenin 53 thote: Shqyrtimi i ofertave "4. Autoriteti kontraktor vlereson nje oterte te vlefshme edhe nese ajo permben devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndrveshojne thelbesisht: karakteristikat, kushtet dhe kerkeset e tjera, te perceptuere ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj."

Pra sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga ana jone tregon qarte pronesine e mjetit dhe dokumenti i cili mungon nuk ndrveshon thelbin.

Ne ju kemi paraqitur dhe keto mjete te cilat jane plotesuese :

1•Mjetin me targa AA409DR kemi paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise.

**Me tonazh 6.7 ton me dokumentacion te sakte. Ak i ka pranuar te rregullta.**

2• Mjetin me targa SR4937B kemi paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise.

**Me tonazh 6.1 ton me dokumentacion te sakte. Ak i ka pranuar te rregullta.**

Ju kerkoni: Vinc me kosh, 12 cope, ne pronesi ose me qera.

Ne ju kemi paraqitur:

1 • Mjetin me targa AA886SG ku ne shtojcen 9 e ka deklaruar vinc me kosh ku ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise. Mjet ne te cilen dhe ju e keni pranuar te rregullt, por dhe ky eshte atuvinc. Shikoni fotot bashkangjitur folderit.

2•Mjetin me targa AA545JN kemi paraqitur kontraten e qerese, ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Ka dokumentacion te rregullt eshte vinxh me kosh po e ka makina prandaj quhet autovinc se e ka vincin makina, shikoni fotot te cilat e vertetojne kete fakt.

3 • Mjetin me targa AA969TY kemi paraqitur kontraten e qerese, ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikata e pronesise. Ka dokumentacion te rregullt eshte vinc me kosh po e ka makina prandaj quhet autovinc se e ka vincin makina, shikoni fotot.

Ne ju kemi paraqitur me fature tatimore dhe keto vinca te cilet nuk jane auto:

1- Fatura Nr ser 75562662 date 10/08/2019 Nr 285 Mini vinc ashensor elektrik pune ne kantier cope 1.

2- Fatura Nr ser 64816881 date 29/05/2009 Nr fat 168 vinc Ngritje peshash cope 4.

3- Fatura Nr ser 87366897 date 28/07/2011 Nr fat 1198. Vinc cope 1.

4-Fatura Nr ser 04082520 date 05/08/2012 Nr fat 20. Vinc cope 2.

Si perfundim per plotesimin e kesaj pike ju kemi paraqitur 3 autovinca me kosh, dhe 8 vinca me kosh me fature tatimore. Pra e kemi permbushur kerkesen e Ak shume here me teper.(referohuni dokumentacionit perkates).

Sa me siper arsyet e skualifikimit nga Ak nuk jane te bazuara ne fakte dhe ne ligje. Ak duhet te kualifikojte shoqerine tone pasi ka permbushur te gjitha kerkesat e dhene ne dst.

II.4. Njëpërmjet shkresës nr. 332/1 prot., datë 08.10.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

*“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) konstaton se pretendimet e ankimesit lidhen me plotësimin të kriterëve të vecanta të kualifikimit, parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, për shtojcën 11 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 11 "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:*

*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).*

<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Gjendja</b>
<i>Kamionçina (kapaciteti mbajtës deri minimumi 1 ton maksimumi 2 ton)</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamiona vetëshkarkuese (kapaciteti mbajtës nga 3.5 ton deri në 5 ton )</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betoniëre</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Depozite uji 1000 litra</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë gjatë fazës vlerësimi të ofertës e deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që autorizon AK për të kryer verifikimin dhe kontrollin e deklaramit ).*
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).”*

*Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimes "SHENDELLI" sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacionin për mjetet si më poshtë:*

1. Mjetin me targa GJ1127B ne shtojcen 9 e ka deklaruar autovinc ka paraqitur kontraten e qerase me date 23.05.2019 me subjektin Aliko Ndertim, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, takse vjetore 2018 dhe foto. I mungon certifikata e pronesise - kerkuar ne DST. Kapaciteti mbajtes per kete mjet eshte 4.9 ton. Dokumentacioni per kete mjet nuk eshte i plote.
2. Mjetin me targa AA409DR ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamion me vinc ka paraqitur kontraten e shitblerjes me date 13.04.2017 me shites Ilir Hasibra, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, certifikaten e pronesise, taksen vjetore te 2019 dhe foto si kamion me vinc. Dokumentacioni per kete mjet eshte i rregullt. Kapaciteti mbajtes i ketij mjete 6.7 ton
3. Mjetin me targa AA886SG ne shtojcen 9 e ka deklaruar vinc me kosh 25 ml ka paraqitur kontrate qeraje me date 21.02.2018 me subjektin Ulgesa, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, taksa vjetore 2018, foto dhe certifikaten e pronesise. Dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte. Kapaciteti mbajtes i ketij mjete 8.4 ton.
4. Mjetin me targa AA074PU ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, takse vjetore 2019, foto dhe certifikaten e pronesise, Dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte. Kapaciteti mbajtes eshte 1.3 ton.
5. Mjetin me targa AA959GS ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, takse vjetor 2019, foto dhe certifikaten e pronesise. Dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte, Kapaciteti mbajtes eshte 1.2 ton.
6. Mjetin me targa AA6930Y ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ka paraqitnr lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, takse vjetore 2019, foto dhe certifikaten e pronesise, Dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte. Kapaciteti mbajtës është 1.1 ton.
7. Mjetin me targa SR4937B ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamion ka paraqitur kontratën e qirase me date 28.05.2019 me subjektin “Jody Kompany” sh.p.k ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikatën për transport mallrash, takse vjetore 2019, foto dhe certifikaten e pronesise, Dokumentacioni per kete mjet eshte i sakte. Kapaciteti mbajtës është 6.1 ton.
8. Mjetin me targa AA545JN ne shtojcen 9 e ka deklaruar autovinc ka paraqitur kontraten e qerase me date 17.05.2019 me subjektin Klaudi Kuka ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikaten e pronesise, Mongon certifikata per transport mallrash. Autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit nuk ka kerkuar autovinc por vinc me kosh.
9. Mjetin me targa AA969TY ne shtojcen 9 e ka deklaruar autovinc ka paraqitur kontraten e qerase me date 17.05.2019 me subjektin Klaudi Kuka ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, foto dhe certifikaten e pronesise. Mungon certifikata per transport mallrash. Autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit nuk ka kerkuar autovinc por vine me kosh.



10. Mjetin me targa AA693RV ne shtojcen 9 e ka deklaruar autobetoniere ka paraqitur kontraten e qerase me date 23.05.2019 me subjektin Aliko Ndertim, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, takse vjetore 2018 dhe certifikaten e pronesie, Kapaciteti mbajtes 14.5 ton. Mjet i cili nuk eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor.

11. Mjetin me targa AA694RV ne shtojcen 9 e ka deklaruar autobetoniere ka paraqitur kontraten e qerase me date 23.05.2019 me subjektin Aliko Ndertim, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia dhe certifikaten e pronesie. Kapaciteti mbajtes 14.5 ton. Mjet i cili nuk eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor.

12. Mjetin me targa AA691JC ne shtojcen 9 e ka deklaruar pres betoni ka paraqitur kontraten e qerase me date 23.05.2019 me subjektin Aliko Ndertim, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, takse vjetore 2018, foto dhe certifikaten e pronesie. Kapaciteti mbajtes 21.9 ton. Mjet i cili nuk eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor.

13. Mjetin me targa AA347KE ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ka paraqitur kontraten e shitblerjes me date 09.05.2016 me shites Edison Kaceli, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, certifikaten e pronesise, taksen vjetore te 2018 dhe foto. Dokumentacioni per kete mjet eshte i rregullt. Kapaciteti mbajtes i ketij mjete 1.9 ton.

14. Mjetin me targa AA043XL ne shtojcen 9 e ka deklaruar kamioncine ku ka paraqitur lejen e qarkullimit date 13.05.2019, certifikaten e pronesise date 19.02.2019, dhe foto. Pas verifikimit nga KSHA certifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit datë 31.10.2018 dhe taksa vjetore eshte per mjetin me targa SK 1256A me pronar A.Omeri. Në ankesën e tij OE deklaronte se këtë mjet e ka blerë nga A.Omeri, kontrate shitblerje e cila mungon – kerkuar ne DST. Ne mbeshetje te ligjit 10076 date 12.02.2009 neni 28 pika 1, theksohet: "Ne rast se ndryshon pronesia e mjetit gjate periudhes se sigurimit, te drejtat dhe pergjegjesite, qe rrjedhin nga kontrata e sigurimit, i kalojne pronarit te ri dhe vlejne deri ne perfundimin e kontrates se sigurimit, perfshire ketu edhe te drejtat e detyrimet e percaktuara ne nenin 8 te ketij ligji. Pronari i ri, brenda 8 diteve, detyrohet te njoftoje shoqerine e sigurimit per ndryshimin e pronesise se mjetit dhe pasqyrimin e ketij ndryshimi ne kontraten e sigurimit", gje e cila nuk eshte permbushur nga OE "Shendelli" sh.p.k. pra polica e sigurimit eshte ne emer te shitesit A. Omeri. Kapaciteti mbajtes per kete mjet eshte 3.6 ton.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike per proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi, perkatesisht shtojcen 9 "Mbi disponimin e makinerive e pajisjeve", me ane te se ciles operatori ekonomik ankimes deklaronte se zoteronte mjetet dhe pajisjet teknike per te realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur per kamioncinat, kamionat vetshkarkues dhe vinca me kosh referuar dokumentit leje e qarkullimit te mjetit, ne te cilin konstatohen te gjitha te dhenat ne lidhje me parametrat e mjetit, ndermjet te cilave edhe kapaciteti mbajtes i tij, ne nr. Rendor 23 dhe 24 jane perkatesisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si me poshte:

Kamioncina kapaciteti mbajtes deri min 1 ton max 2 ton (2 cope)

Mjeti me targa AA074PU, kapaciteti mbajtes = 1.3 ton (me pak se 2 ton)

Mjeti me targa AA959GS, kapaciteti mbajtes = 1.2 ton (me pak se 2 ton)  
Mjeti me targa AA693OY, kapaciteti mbajtes = 1.1 ton (me pak se 2 ton)  
Mjeti me targa AA345KE, kapaciteti mbajtes = 1.9 ton (me pak se 2 ton)  
Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes nga 3.5 deri 5 ton (2 cope)  
Mjeti me targa SR4937B, kapaciteti mbajtes = 6.1 ton (me shume se 5 ton)  
Mjeti me targa AA043XL deklaruar kamioncine, kapaciteti mbajtes = 3.6 ton (me pak se 5 ton)  
Vinc me kosh (2 cope)  
Mjeti me targa AA409DR deklaruar kamion me vinc, kapaciteti mbajtes=6.7ton (me shume se 5 ton).  
Mjeti me targa GJ1127B deklaruar autovinc, kapaciteti mbajtes = 4.9 ton  
Mjeti me targa AA886SG vinc me kosh 25 ml, kapaciteti mbajtes = 8.4 ton  
Mjeti me targa AA545JN autovinc  
Mjeti me targa AA969TY autovinc

Operatori ekonomik ankimues nuk e permbush kriterin e percaktuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit per paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton dhe 2 mjeteve vinc me kosh. Konstatohet se, ne rastin e disponimit te mjeteve me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton ton, mjetet e deklaruar nga operatori ekonomik ne shtojcen 9 jane kamion me targa SR 4937B me kapacitet mbajtes 6.1 ton me shume se 5 ton dhe kamioncine me targa AA043XL me kapacitet mbajtes 3.6 ton mjet. Pra nje nga mjetet ka tejkaluar kapacitetin mbajtes te kerkuar nga autoriteti kontraktor, ndersa mjeti tjetër është deklaruar kamioncine dhe ka problematika me dokumentat e kerkuara. Ndersa lidhur me disponimin e mjeteve vinc me kosh mjetet e deklaruar nga operatori ekonomik ne shtojcen 9 jane tre autovinc, nje kamion me vinc dhe nje vinc me kosh. Autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit nuk ka kerkuar autobetoniere, pres betoni, autovinc, kamion me vinc por kamioncine, kamion vetshkarkues, betoniere dhe vinc me kosh. Gjykojme se bazuar ne nenin 82 pika 1 te ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", është barre e operatorit ekonomik ankimues pjesemarrës ne proceduren e prokurimit objekti shqyrtimi, te vertetoje se disponon kapacitetet teknike ne lidhje me mjetet. Sqarojme se, kriteri per mjetet duhet pare dhe vleresuar ne teresine e tij, me te gjithë elementet e kerkuar dhe percaktuar nga antoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangesive dhe pasaktesirave te konstatuara ne dokumentacion, nuk arrihet te plotesohet tonazhi i kerkuar i mjeteve, pare kjo ne kendveshtrimin e vleresimit te te gjitha te dhenave te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit.

II.5. Në datën 17.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 01.11.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1632/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 8561/1 prot., datë 30.10.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Shendelli” sh.p.k, se: “Mjetin me targa GJ1127B ne shtojcen 9 e ka deklaruar autovinc ka paraqitur kontraten e qerese me date 23.05.2019 me subjektin Aliko Ndertim, lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, takse vjetore 2018 dhe foto. I mungon certifikata e pronesise - kerkuar ne DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 11 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 11, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).*

<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Gjendja</b>
<i>Kamionçina (kapaciteti mbajtës deri minimumi 1 ton maksimumi 2 ton)</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamiona veteshkarkuese (kapaciteti mbajtës nga 3.5 ton deri ne 5 ton )</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronesi ose me qera</i>
<i>Betoniere</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronesi ose me qera</i>
<i>Depozite uji 1000 litra</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronesi ose me qera</i>

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë gjate fazes vleresimiti te ofertes e deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara*

sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që autorizon AK për të kryer verifikimin dhe kontrollin e deklaramit).

- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e informacionit të paraqitur.

### III.1.2. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pretendon se:

Ju kerkoni: “Kamiona vetëshkarkuese (kapaciteti mbajtes nga 3.5 ton deri në 5 ton ), 2 cope, pronësi ose me qera”, në ju kemi paraqitur:

Mjetin me targa AA043XL. Ju për këtë mjet deklaroni: Mjetin me targa AA043XL ku në shtojcën 9 e ka deklaruar kamioncinë ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën pronësie, foto për certifikatën e kontrollit teknik është për mjetin me targa SK125GA. Për rrjedhojë dokumentacioni për këtë mjet nuk është i plotë për rrjedhojë të pasakte.

Kundershtim pika:

Për mjetin me targa AA043XL në ju kemi paraqitur: Certifikatën transport në emer të Shendelli sh.p.k date 28/02/2019 me numer shasie ËDB6690421P123340, Leja e qarkullimit me Nr shasie: ËDB6690421P123340 në emer të Shendelli sh.p.k, date 13/05/2019, taksat vjetore në emer të Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 me numer shasie ËDB6690421P123340, sigurimi teknik në emer të Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 Me nr shasie ËDB6690421P123340, Tahografi në emer Arta Flamur Omeri date 31/10/2018 me nr shasie ËDB6690421P123340, Certifikatën e kontrollit teknik me targa SK125GA me numer shasie ËDB6690421P123340, Pronësia në emer të Shendelli sh.p.k me nr shasie ËDB6690421P123340 date 19.02.2019.

Për sa me sipër dokumentacioni i paraqitur nga ana jone tregon që është e njëjta makine dhe kjo faktohet me nr e shasise i cili është i njëjti të të gjitha dokumentat. Për dokumentat e paraqitura të folderi "Shendelli" Kamion AA043XL 3.66 TON 30.10.2019" i perkasin të njëjtit mjet dhe jo dy mjete të ndryshme sic pretendon AK. Kjo makine është blerë nga shoqëria jone nga Arta Flamur Omeri, e cila figuron si emer në disa dokumentat, për ky automjet tashmë është i shoqërisë sone dhe faktohet nga akti i pronësisë dhe dokumentacioni i paraqitur është i rregullt deri me datën 31/10/2019. Për dokumentacioni është i rregullt dhe Ak mund të verifikojë duke iu referuar nr të shasise, element i cili nuk ndryshon asnjehere të një automjet. Mjeti ka tonazhin 3.66 ton dhe është i rregullt.

Pretendimi juaj që mjeti me targa AA043XL nuk ka dokumentacionin e sakte nuk qëndron.

Në ju kemi paraqitur: Mjetin me targa GJ1127B

Mjetin me targa GJ1127B ku në shtojcën 9 e ka deklaruar autovincin ku ka paraqitur kontratën e qerës me subjektin Alike Ndertim ka paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik, certifikatën për transport mallrash nga bashkia, foto për i mungon certifikatën e pronësisë.

Mjetin me targa GJ11276 ka tonazh 4.940.

Ky mjet nuk ka certifikatën e pronësisë, për kjo nuk do të thotë që dokumentacioni është i pasakte dhe se pronësia e mjetit nuk verifikohet, pasi pronësinë e mjetit e tregon dhe leja e qarkullimit dhe dokumentacioni tjetër bashkangjitur. Pronësia është një element e cila faktohet dhe me dokumenta të tjera përveç certifikatës së pronësisë, dhe mungesa e saj nuk

*do te thote qe i gjithe dokumentacioni eshte i parregullt dhe nuk mund te merret parasysht nga Ak. Ne kete rast po ti referohemi ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, ndryshuar me ligjin Nr.9800 date 10.09.2007, ligjin Nr. 9855 date 26.12.2007, ligjin nr. 10170, date 22.10.2009, dhe ligjin nr.10 309, date 22.07.2010, i cili eshte rregullatori kryesor per procedurat e prokurimit publike, ne nenin 53 thote: Shqyrtimi i ofertave "4. Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permben devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndrshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkeset e tjera, te perceptuere ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj." Pra sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga ana jone tregon qarte pronesine e mjetit dhe dokumenti i cili mungon nuk ndryshon thelbin.*

*Ne ju kemi paraqitur dhe keto mjete te cilat jane plotesuese :*

*1•Mjetin me targa AA409DR kemi paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise. Me tonazh 6. 7 ton me dokumentacion te sakte. Ak i ka pranuar te rregullta.*

*2• Mjetin me targa SR4937B kemi paraqitur lejen e qarkullimit, policen e sigurimit, certifikaten e kontrollit teknik, certifikaten per transport mallrash nga bashkia, foto dhe certifikata e pronesise. Me tonazh 6.1 ton me dokumentacion te sakte. Ak i ka pranuar te rregullta.*

III.1.3. Sipas ankesës së depozituar nga operatori ekonomik ankimues në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton se për plotësimin e kërkesës së parashikuar në kriteret kualifikuese të dokumentave të tenderit të mësipërm për 2 kamiona veteshkarkuese (kapaciteti mbajtës nga 3.5 ton deri ne 5 ton), në pronësi ose me qira, shoqëria “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion për katër automjete e konkretisht:

Mjeti me targa AA043XL, 3.66 ton

Mjeti me targa GJ1127B, 4.940 ton,

Mjeti me targa AA409DR, 6.7 ton

Mjeti me targa SR4937B, 6.1 ton

Nga verifikimi i bërë në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se ankimuesi ka paraqitur dokumentacion për 4 automjetet e mësipërme, të cilat rezultojnë me tonazhet e pohuara nga ankimuesi.

Lidhur me mjetet me targa AA409DR, 6.7 ton dhe SR4937B, 6.1 ton, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se këto mjete nuk kanë tonazhin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor pasi kapaciteti mbajtës i tyre duhet të jetë nga 3.5 ton deri ne 5 ton, ndërkohë që këto dy mjete e kanë tonazhin më të madh se 5 ton dhe konkretisht 6.7 ton dhe 6.1 ton, duke mosplotësuar kërkesës për tonazhin e mjeteve.

Përsa i përket mjetin me targa GJ1127B 4.940 ton, nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se është paraqitur dokumentacioni si vijon: Kontratë qiraje datë 23.05.2019 me nr. 1081 rep, nr.400 kol me qiradhënës “Aliko Ndërtimi” sh.p.k dhe qiramarrës “Shendelli” sh.p.k, shoqëruar me Leje qarkullimi, Certifikatë e kontrollit teknik, Siguracioni i mjetit, taksat vjetore, certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, foto. Për mjetin me targa GJ1127B 4.940 ton mungon certifikata e pronësisë së mjetit.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 5, përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

*c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”*.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë

autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu edhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se, në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, KPP konstaton se, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar një listë të mjeteve dhe të paisjeve të cilat janë të nevojshme për realizimin e synimit parësor të autoritetit kontraktor, të përmbushjes me sukses të kontratës objekt prokurimi, për të cilat janë kërkuar dhe një sërë dokumentash për të vërtetuar disponimin e tyre (në pronësi ose me qera).

III.1.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e 2 mjeteve me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton. Konstatohet se, në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për 2 kamiona veteshkarkuese (kapaciteti mbajtës nga 3.5 ton deri ne 5 ton), në pronësi ose me qira, KPP rezulton se, nga katër mjetet e ofruara nga ankimuesi, dy prej tyre nuk plotësojnë kërkesën për tonazhin e konkretisht mjetet me targa AA409DR, 6.7 ton dhe SR4937B, 6.1 ton, ndërsa për mjetin me targa GJ1127B 4.940 ton ankimuesi nuk ka paraqitur certifikatën e pronësisë së mjetit, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor që *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve”*.

Përsa i përket mjetit me targa AA043XL, 3.66 ton, edhe në supozimin që ky mjet përmban dokumentacion në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor si më sipër cituar, ankimuesi nuk arrin të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor për dy kamiona veteshkarkuese (kapaciteti mbajtës nga 3.5 ton deri ne 5 ton).

Për më tepër rezulton se në ofertën e paraqitur nga shoqëria “Shendelli” sh.p.k informacioni i dhënë nuk është i qartë pasi në shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive” të plotësuar prej tij konstatohet se emertimet mjeteve të ofruara nuk janë “kamionë vetshkarkues”, por janë emërtuar “kamion me vinc” për mjetin me targë AA409DR, “kamioncin” për mjetin AA043XL, “kamion” për mjetin SR4937B dhe “autovinc” për mjetin me targë GJ1127B, duke vështirësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Prokurimit Publik në identifikimin e mjeteve të ofruara.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor në lidhje dokumentat e tenderit, etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësisht të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” sh.p.k nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk



ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-34675-08-31-2019, me objekt: “Rehabilitim/forcim të banesave ekzistuese në fshatin Piskove dhe Pacomit”, me fond limit 9.905.233 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 17.09.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1632 Protokolli**

**Datë 17.10.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**